

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	ZBULIMI I BUJSHEM/ Del në drite një qytet me 6 mozaikë të shekullit të IV në Qesarat Tepelenë, spikat kompozimi i Erosit (FOTOT E JASHTEZAKONSHME)
ADRESA	https://newsbomb.al/kultureart/zbulimi-i-bujshem-del-ne-drite-nje-qytet-me-6-mozaike-te-shekullit-te-i401881
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:54:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 08:29:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2d77ef8876d3d8d8bb43b36a5e81f9f5e70afe29c2e758c823db113f2b3949b9
TEKSTI	5d82d0c0fcc69be27e0fdb79a9b0c44f7f565297110923813d711c180fb2f503
PAMJA	fc24e68194be287a1e69654f5e91ea5408f9342f45b82633ae353c6f40e2dd50

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8a1ea07a2c27a49ad2cfb22c9ba0bdac426ae3969bfd1720c69680d1c6a24ff2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/8a1ea07a2c27a49ad2cfb22c9ba0bdac426ae3969bfd1720c69680d1c6a24ff2

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

[Kreu](#) [Politikë](#) [Aktualitet](#) [Ekonomi](#) [Kulturë & Art](#) [Rajon](#) [Sport](#) [Bota](#) [Showbiz](#) [SocialBomb](#)

Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Kulture & Art

23 Shtator 2026, 10:29

ZBULIMI I BUJSHEM/ Del në dritë një qytet me 6 mozaikë të shekullit të IV në Qesarat Tepelenë, spikat kompozimi i Erosit (FOTOT E JASHTEZAKONSHME)



Shkruar nga Newsbomb



Mozaiket ne Qesarat te Tepelenës

Nga Engjëlli SERJANI

Zbulim i bujshëm arkeologjik në Qesarat të Tepelenës

Del në dritë një qytet me gjashtë mozaikë të shekullit IV

Një zbulim i rëndësishëm arkeologjik vjen nga Qesarati i Tepelenës, ku ekspedita arkeologjike shqiptaro-italiane ka nxjerrë në dritë një kompleks të pasur arkitektonik, me gjashtë dysheme të dekoruara me mozaikë shumëngjyrësh, figura njerëzore, motive geometrike dhe fragmente pikturash murale.

Zbulimi është bërë gjatë fushatës së vitit 2026, në kuadër të projektit arkeologjik shqiptaro-italian "Arkeologjia e peizazhit në zonën Tepelenë-Memaliaj", të organizuar nga Akademia e Studimeve Albanologjike, në bashkëpunim me Universitetin "Aldo Moro" të Barit dhe me mbështetjen e Ministrisë së Jashtme të Italisë.

Lajmin e kanë bërë të ditur vetë arkeologët që drejtojnë kërkimet: Prof. Eduart Shehi, Prof. Sabina Veseli, e Institutit të Arkeologjisë dhe Akademisë së Studimeve Arkeologjike të Tiranës, si dhe Prof. Cunstade Silvio Fiorilella, nga Universiteti "Aldo Moro" i Barit.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Bota

Rusia godet qendrat e të dhënave në Kiev, ndërpritet interneti për 100 mijë familje



Aktualitet

GJKKO e do në burg për trafikimin e dhjetërave ton kokainë, PRANGOSET në Rusi i shumëkërkuari Shpëtim Aliu, "shoku" i Eldi Dizdarit pritët t'i dorëzohet Shqipërisë (DETAJE)

Zbulu më shumë artikuj >

Gjatë punimeve arkeologjike në rrënojat e një ndërtese komplekse dhe luksoze, që ndodhet rreth 400-500 metra në të djathtë të rrugës kombëtare në drejtim të Tepelenës dhe Gjirokastrës, arkeologët kanë zbuluar gjashtë sipërfaqe dyshemeje të zbuluara me mozaikë.

Sipas interpretimit të specialistëve, kompleksi lidhet me periudhën romake dhe me dëshmi të jetës në antikitetin e vonë. Mozaikët, megjithëse të dëmtuar pjesërisht, janë ruajtur në përgjithësi në gjendje të mirë.

Mes tyre spikat veçanërisht një kompozim figurativ ku paraqitet Erosi, i vendosur në një prej sipërfaqeve të mozaikut, pranë një pjese të dëmtuar të dyshemesë. Prania e figurave njerëzore, krahas motiveve gjeometrike dhe elementeve të tjera dekorative, e bën këtë koleksion një prej dëshmime më interesante të zbuluara në këtë territor.



Por zbulimi nuk kufizohet vetëm te bukuria e mozaikëve.

Gërmimet kanë nxjerrë në pah gjurmë të një ndërtese të madhe, me ambiente termale dhe elemente të tjera arkitekturore që dëshmojnë për një jetë të zhvilluar në këtë territor në antikitet. Përmasat, pasuria e dekorimit dhe karakteri i strukturës kanë ngritur edhe pyetje mbi funksionin dhe statusin e saj në peizazhin e lashtë të Qesaratit.

Sipas arkeologëve, kompleksi mund të ketë qenë i lidhur me një fermë më të hershme, që i përket fundit të periudhës qytetare ilire, duke dëshmuar vazhdimësinë dhe transformimin e jetës në këtë territor nga periudha ilire drejt asaj romake.

Një territor i njohur për pasurinë arkeologjike





Qesarati nuk është një territor i panjohur për arkeologjinë. Më herët, në këtë zonë janë zhvilluar edhe gërmime arkeologjike shpëtimi, ndërsa kërkimet sistematike të projektit shqiptaro-italian kanë sjellë të dhëna të reja mbi shtrirjen dhe kompleksitetin e trashëgimisë së saj.

Gjatë vëzhgimeve dhe sondazheve të kryera në vitin 2025, në një sipërfaqe prej rreth 70 hektarësh, ekipi arkeologjik regjistroi 67 njësi topografike dhe identifikoi rreth 20 site, pothuajse të gjitha shumështrësore.

Këto të dhëna shpjegojnë edhe interesin e veçantë të arkeologëve për vazhdimin e kërkimeve në këtë zonë gjatë fushatës së vitit 2026.

Këtë vit, vëmendja u përqendrua pikërisht te rrënojat e ndërtesës së madhe, të pasur me gjurmë arkitekturore, ambiente termale dhe dëshmi të tjera të jetës në antikitetin e vonë. Dhe ishte pikërisht kjo fushatë që solli në dritë gjashtë dyshemetë e mozaikëve, duke i dhënë një dimension të ri njohjes së Qesaratit antik.

Zbulimi ngre tashmë pyetje të reja për shtrirjen e vendbanimit dhe marrëdhënien e tij me strukturat e tjera të evidentuara në territor. Përgjigjet do të varen nga vazhdimi i gërmimeve dhe studimi i materialit të zbuluar.

Një tjetër halkë në peizazhin arkeologjik të Vjosës





Zbulimi i Qesaratit merr një rëndësi të veçantë edhe për faktin se ai ndodhet në një territor jashtëzakonisht të pasur me dëshmi të qytetërimeve të ndryshme.

Në hapësirën e gjerë të luginës së Vjosës dhe në territoret përreth saj gjenden site dhe monumente të rëndësishme arkeologjike, ndër të cilat Antigonea, Dedejani, Kalaja e Këlcyrës, Lekli, Kalaja e Matohasanajt, Amantia, Mavrova, Bylisi, Klosi dhe Apolonia.

Në të dy brigjet e Vjosës dhe përgjatë degëve të saj ruhen dëshmi të një historie të gjatë, që shtrihet nga periudhat e hershme parahistorike dhe neoliti i vonë, përmes epokës së bronzit dhe periudhës ilire, deri te periudhat romake, mesjetare dhe osmane.

Në këtë mozaik të gjerë të trashëgimisë së Jugut, Qesarati sjell tashmë një dëshmi të re.




Gjashtë dyshemetë me mozaikë, figura e Erosit, gjurmët e pikturave murale, ambientet termale dhe vetë struktura e kompleksit hapin një faqe të re për njohjen e historisë së këtij territori.

Dhe, ndoshta, pjesa më interesante e këtij zbulimi është pikërisht ajo që ende fshihet nën tokë.

Gërmimet e vitit 2026 kanë hapur një dritare të re drejt Qesaratit antik. Vazhdimi i tyre mund të tregojë se sa e madhe është në të vërtetë kjo histori që sapo ka nisur të dalë në dritë.

Galeria fotografike ()



Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.